



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:047084

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05727810

Ac.nr.8463/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Enes Mehmeti dhe Besnik Feka, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D.S nga fshati L....., Komuna e P....., të cilët me autorizim i përfaqëson M.Sh, avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prizren, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.838/2022 i datës 31.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prizren, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.838/2022 i datës 31.10.2022 dhe gjykohet si në vijim: REFUZOHET e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit D.S nga fshati L....., Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura, që paditësit në emër të një page jubilarë në shumën prej 314.22 € për 10 vite përvojë pune, me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë e deri në përmbushjen definitive, e të gjitha në afat prej 7 ditësh nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.838/2022 i datës 31.10.2022, ka vendosur: *‘I. APROVOHET - kërkesëpadia e paditësit D.S nga fshati L....., Komuna e P....., si e bazuar.*

II. DETYROHET e paditura Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prizren, që të ia paguan paditësit, në emër të kompensimit të pagës jubilarë për D.S, në emër të një page jubilarë në shumën prej 314.22 €, të cilën është e detyruar e paditura Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prizren që t'i paguan paditësit të lartcekur në shumën prej 314.22 €, (treqind e katërmbëdhjetë euro e njëzet e dy cent), me kamatë ligjore për 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedh nga data e paraqitjes së padisë 10.03.2022, e deri në përmbushjen definitive të gjitha këto afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

III. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 98.00 (nëntëdhjetë e tetë) euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm''.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që të aprovojë ankesën dhe ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta refuzojë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarës së saj, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës me datë 10.03.2022, ka kërkuar nga gjykata që të obligohet e paditura, që paditësit për 10 vite përvojë të punës ti paguaj 50% e një page bazë pra shumën prej 314.22 € me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësve, pa shqyrtim të çështjes, në bazë të nenit 398 të LPK-së, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.838/2022 i datës 31.10.2022, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së me të cilin përcaktohet se: "kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë

kërkesëpadinë”, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se: “kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, pasi që gjykata ka provuar faktin se Mes palëve nuk rezultoi të jetë kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura. Gjykata në bazë të vërtetimit për përvojën e punës dhe atë sipas librezës së punës me numër të serisë 101912 dhe numri i regjistrit 602, të datës 21.03.1985, për pagën jubilarë për paditësi D.S, ka 18 vite, 10 muaj, e 10 ditë përvojë pune dhe i takon një page bazë, këto janë fakte që vërtetojnë përvojën e punës. Vërtetimi i lartcekura, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj. Andaj, librezë e punës të lëshuar nga institucionet e atëhershme po që brenda saj tregohet se ka qenë në marrëdhënien pune tek e paditura QKMF –në Prizren, si prova me të cilat vërtetohen faktet lidhur me përvojën në punë, gjykata ia fali besimin e plotë, andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e cekura më lart, gjykata duke bazuar në nenin 17 paragrafi 3 pika 3.1 të KKSK-së, gjeti se paditësit i takon e drejta e kompensimit për shpërblimin jubilar në vlerë të një page baze për shkak të përvojës së punës 10 vite, andaj duke llogaritur pagën bazë në shumë prej 314.22, rezultoi se paditësit i takon e drejta për shpërblim jubilar për lartësinë e aprovuar.

Për bazën juridike i është referuar dispozitës së nenit 17 paragrafi 3 pika 3.1 të Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë, e datës 12.06.2018 e cila ka hyrë në fuqi menjëherë, lidhur me kamatën iu referuar nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës iu referua nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por që nga gjendja faktike e konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, prandaj aktgjykimi i ankimuar është dashur të ndryshohet dhe të gjykohet si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, ku nga përmbajtja e ankesës nuk mund të kuptohet se cila dispozitë e procedurës kontestimore është shkelur. Kjo gjykatë konstaton se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, ku dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadiës e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë. Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, por në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka edhe aktgjykimi i atakuar është dashur të ndryshohet dhe të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit nuk i pranoi pretendimet ankimore të paditurës për zbatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me shikim në shkresat e lëndës gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka konstatuar gjendjen faktike duke vërtetuar faktin se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura nga data 01.05.2001, në QKMF në Prizren, gjë që vërtetohet nga librezja e punës me numër të serisë 101912 dhe numër i regjistrimit 602 të datës 21.03.1985, ku rezulton se paditësi tek e paditura ka 18 vite, 10 muaj e 10 ditë përvojë pune ku vitin jubilar, respektivisht 10 vite përvojë pune e ka përmbyshur me datë 01.05.2011, ndërsa t paga mujore bazë e paditësit është në lartësi prej 314.22 €.

Nga gjendja e konstatuar faktike, kjo gjykatë gjeti se nuk është zbatuar drejtë e drejta materiale. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë e ka përcaktuar edhe arsyetimin e aktgjykimit për kompensimin e pagës jubilarë në atë mënyrë që përfundimi meritator është arsyetuar në përputhje me dispozitat e LPK-së, pavarësisht se një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë, gjykata ankimore e ka ndryshuar.

Lidhur me kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e shpërblimit jubilar Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar konform nenit 195. 1 pika e) e lidhur me nenin 201 pika d) e LPK-së.

Me dispozitat e nenit 90 parag.1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me parag.1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me parag.3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me parag.4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*. Poashtu me nenin 17 parag.3, të Kontratës Kolektive Sektoriale, e cila ka hyrë në fuqi me datën 11.06.2018, përcaktohet se: *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.1. Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një paga mujore të tij; 3.2. Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; 3.3. Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit në vlerë të tri paga mujore të tij”*. Me nenin 17 parag.4 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se: *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësisimit të kushteve nga ky paragraf”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit, nuk e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, për arsye se: Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë, edhe pse ka qenë në fuqi në kohën e parashtrimin të padisë nga ana e paditësit dt. 10.05.2022 (Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë ka hyrë në fuqi më datë 12.06.2018) dhe e njëjta edhe pse është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 të Ligjit të Punës, në rastin konkret kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pathemeltë, për faktin se në këtë rast paditësit nuk i takojnë benefitet nga Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë, duke marrë parasysh faktin se kjo kontratë nuk ka qenë në fuqi, e as ndonjë marrëveshje tjetër kolektive, në kohën kur paditësja ka arritur vitin jubilar për 10 vjet përvojë pune, sepse paditësi 10 vite përvojë pune i ka mbushur me datë 01.05.2011. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka konstatuar që kërkesëpadia e paditësit është e themeltë dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar duke e ndryshuar të njëjtin me refuzimin e kërkesëpadiës.

Nga arsyet e theksuara gjykata ankimore vlerëson se kërkesëpadia e paditësit për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, andaj kjo gjykatë ka vendosur që ta aprovojë si të themeltë ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ndryshuar, duke e refuzuar të pathemeltë kërkesëpadiinë e paditësit, si dhe ka vendosur për shpenzimet e procedurës konform nenit 450 të LPK-së.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit në bazë të nenit 194, 195 par.1 pika e), lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8463/2022, me datë 22.05.2024

Kryetarja e kolegjit
Nora Bllaca-Dula, d.v.